VENDIM
Nr. 5, datë 9.5.2014

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR NDARJEN E FONDIT PËR ARSIMIN, FONDI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

(Ndryshuar me vendimin nr. 19 , datë 19.11.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3 të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, "Për buxhetin e vitit 2014", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes për projekte në fushën e arsimit (arsimi bazë, i mesëm dhe profesional), në lidhje me shpërndarjen e fondeve në vlerën 680 000 000 (gjashtëqind e tetëdhjetë milionë) lekë, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014. Kjo thirrje për aplikim përfshin, si më poshtë vijon:

a) projekte (pilot) për zhvillimin e arsimit të mesëm, bazë dhe profesional, si dhe të shkollës si qendër komunitare (institucionet aplikuese janë bashkitë qendër qarku);

b) projekte të rehabilitimit të shkollave në gjendje emergjente për ndërhyrje.

2. Aplikimi për fonde të thirrjes për financimin e projekteve të arsimit (bazë, të mesëm dhe profesional), sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur. Institucionet aplikuese janë njësitë e qeverisjes vendore. Aplikimet për projektet dërgohen sipas formatit të dhënë në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Shqyrtimi për financim bëhet për projektet e aplikuara, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Procedura e vlerësimit kryhet pranë sekretariatit përkatës teknik, në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, si dhe pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas kritereve të dhëna në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sporteve, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	anëtar		
Ministri i Financave	anëtar		
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit		anëtar	
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës		anëtar	
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes			anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar		
Ministri i Shëndetësisë		anëtar	
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave		anëtar	
Ministri i Kulturës	anëtar		
Ministri i Mjedisit	anëtar		
Ministri i Punëve të Brendshme		anëtar	
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore		anëtar	
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë		anëtar	
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë		anëtar	
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë		anëtar	
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore		anëtar	

SHTOJCA I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekt-aplikime për projekte të arsimit (bazë, të mesëm dhe profesional)
Për një periudhë 8-ditore, pas botimit në Fletoren Zyrtare	Aplikuesit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, si më sipër	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi online në faqen elektronike: www.dsdc.gov.al.; 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik (Ministria e Arsimit dhe Sporteve) 3. Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit.
6 ditë nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sporteve)	Vlerësimi teknik e financiar i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III.
	Sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sporteve)	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve me vlerësimin përkatës, teknik dhe financiar.
3 ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Vlerësimi i përputhshmërisë me planet vendore, ndërvendore dhe rajonale, i projekteve të aplikuara, sipas pikës B, shtojca III.
	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Përgatit materialet për vendimmarrje për Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve.
2 ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati i përgjithshëm	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR)	Vendimmarrje në lidhje me projektet për t'u financuar, nga thirrja e financimit për projekte të arsimit, si pjesë e FZHR-së.

SHËNIM – Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik dhe financiar të projekteve, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik dhe financiar i projekteve, sipas kritereve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit, kryhet nga sekretariati teknik për objektet e arsimit, i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

2. Sekretariati teknik i paraqet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kritereve të përcaktuara në pikën A të shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.

3. Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën B të shtojcës II, bashkëlidhur vendimit.

SHTOJCA II: FORMATI I APLIKIMIT

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues: autoriteti i qeverisjes vendore (qarqet, bashkitë, komunat), autoritetet dhe agjencitë zhvillimore
Data e aplikimit (*)	
Titulli i projektit (*)	
Lloji/sektori i projektit (*)	Të përcaktohet cili është sektori ku bën pjesë projekti (arsim)
Nënsektori i projektit (*)	Të përcaktohet nënsektori i projektit (arsimi bazë, i mesëm, profesional)
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; - Përshkrimi i kushteve të ndërtesës ekzistuese (nëse ka) dhe terrenit, si dhe i nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i punimeve/ndërhyrjeve shtesë (sistem ngrohje, mur rrethues, etj.) në ndërtesat ekzistuese (nëse ka); - Cilat janë problemet që ky projekt adreson dhe shkalla e ndikimit; - Rrisqet për zbatimin e tij; - Informacion në lidhje me pronësinë e tokës (n.q.s. parashikohet ndërtimi i një objekti të ri) etj.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit, si dhe objektivat specifikë të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë (nxënës/mësues/komunitet) që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike, nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kostoja për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga NJQV-të apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore	
Financim nga donatorë	Nëse ka financim nga donatorë
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/Jo

Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*)	Të përshkruhet nëse projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimi i punimeve.
Dokumentet e miratimit të projektit nga Njësia e Qeverisjes Vendore (*)	Të paraqiten dokumente për të vërtetuar nëse projekti: - ka vendim të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore për miratimin e projektit; - ka vendim të këshillit të njësisë vendore (komunës/qarkut/bashkisë) për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe ndërtimit të projektit; - është përfshirë në listën e miratuar nga këshilli i njësisë vendore për financim (kur është parashikuar bashkëfinancimi); - është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet numri dhe data e miratimit të vendimit, si dhe të bashkëngjitet një kopje e vendimit/dokumenteve të tjera.
Planifikimi vendor, ndërvendor, rajonal (*)	Të paraqitet dhe të specifikohet, nëse projekti është: - pjesë e strategjisë vendore (të bashkisë apo të komunës); - pjesë e strategjisë së zhvillimit të qarkut; - pjesë e planeve të investimeve kapitale të njësisë së qeverisjes vendore; - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç'lloj plani). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura, të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo të planit, si dhe të citohet dokumenti.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik; - preventivin; - argumentimin teknik; përllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit.

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

SHËNIM: Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

- Online në faqen elektronike: www.dsdc.gov.al, si edhe
- me shkresë zyrtare (postë), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit pranë sekretariatit teknik (Ministria e Arsimit dhe Sporteve).

2. Përveç aplikimit si më lart, institucionet aplikuese duhet t'i dërgojnë një shkresë zyrtare Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave. Shkresa zyrtare përmban njoftimin për dërgimin e aplikimit pranë sekretariatit teknik (MAS) dhe listën e projekteve të aplikuara. Projektet e aplikuara duhet të jenë të renditura sipas prioritetit që i ka dhënë institucioni aplikues.

SHTOJCA III: KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Pika A. Kriteret e vlerësimit teknik dhe financiar

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi maksimalisht me 70 pikë i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik për projektet e arsimit, i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS).

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Përmes këtij kriteri vlerësohet nëse projekti që do të financohet, ka:

- projekt teknik, të detajuar saktë dhe qartë (harta, gentplane, etj.); dhe
- preventiv dhe kostim të projektit, të përpiluar dhe të vlerësuar saktë nga institucioni aplikues, sipas çmimeve të referencës në buletinet e përditësuara, etj.

Sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS), ngarkohet të kryejë rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial, të paraqitura nga institucioni aplikues, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të përgatisë raportin e vlerësimit financiar të tyre dhe rekomandimet përkatëse.

Vlerësimi teknik e financiar do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 25 pikë.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike (të jepet informacion edhe në lidhje me pronësinë e tokës, në rastet e ndërtimit të objekteve të reja).

Vlerësimi i nivelit të ulët të riskut vlerësohet me 0 deri maksimalisht 10 pikë.

3. Niveli i ndikimit të projektit:

a) në shërbimet bazë, cilësinë e jetës, shëndetin, arsimimin dhe zhvillim social të zonës në përmirësimin e perspektivës për punësim dhe përdorimit dhe zhvillimit të aftësive. **Për këtë komponent, vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë**.

b) Në nevojën për ndërhyrje të menjëhershme në infrastrukturën arsimore, duke adresuar edhe shkakun. **Për këtë komponent, vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë**.

Totali i pikëve të vlerësimit për nivelin e ndikimit shkon nga 0 deri në 10 pikë.

4. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve**. Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri në maksimalisht 5 pikë**.

5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të nxënësve/mësuesve/ banorëve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ ose të tërthortë. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 10 pikë**.

6. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i ndikimit në mjedis, analiza kosto - përfitim etj. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 5 pikë**.

7. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues, etj. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 5 pikë**.

Pika B. Kriteret e vlerësimit të përputhshmërisë

Përdoren nga Sekretariati i Përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar në nivel vendor, ndërvendor apo rajonal, duke vlerësuar një projekt me **maksimalisht 30 pikë**, sipas kritereve në vijim:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë /strategjitë vendore dhe/ ose të zhvillimit të nivelit

rajonal dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonal/ kombëtar. **Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë**.

2. Shkalla e ndikimit në zhvillimin social në qendrat kryesore të qarkut, ose sa projekti i investimit ndikon në konsolidimin e strukturës arsimore dhe sociale në zonën ku ndodhet projekti. **Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë**.

(Ndryshuar me vendimin nr. 19, datë 19.11.2014)

Tabela 1. Lista e projekteve të Arsimit, me reduktim apo shtesë financimi për 2014, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i Projektit	Vlera e kontratës (me TVSH)	Vlera e financimit 2014 (Lekë)	Fonde që reduktohen (Lekë)	Fonde që shtohen (Lekë)
		QARKU BERAT				
1	Komuna Roshnik	Ndertim i shkolles 9-vjecare +kopsht, Karkanjoz, komuna Roshnik	19,929,917	9,487,338		10,442,579
2	Bashkia Berat	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Thimi Tani" Bashkia Berat	24,334,872	15,882,948		
3	Bashkia Ura Vajgurore	Sistemim, rrethim oborri, ndertim palestre shkolla e bashkuar, lagjia "4 Shtatori" Ura Vajgurore, Bashkia Ura Vajgurore		17,580,367	8,790,184	
4	Komuna Gjerbes	Rikonstruksion pjesor shkolla 9-vjecare fshati Zaloshnje, Komuna Gjerbes, Skrapar	5,406,377	5,835,450	429,073	
5	Bashkia Berat	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Kristaq Capo" Bashkia Berat	26,255,240	16,707,257		
		QARKU DIBER				
6	Komuna Gjoricë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare dhe palestër Gjorice, Komuna Gjorice	38,962,110	19,058,665		
7	Komuna Xibër	Shkolla e bashkuar Xibër, Komuna Xibër	55,673,854	26,836,928		9,351,077
8	Komuna Kala e Dodes	Rikonstruksioni i shkolles 9-vjecare dhe ndertim palester Radomire, Komuna Kala e Dodes	38,042,771	21,308,115		16,734,656
9	Komuna Lis	Rikonstruksioni i shkollës së mesme te bashkuar "Abdyrrahman Përmeti", Komuna Lis (me prioritet	23,169,907	11,118,140		12,051,767
	Bashkia Peshkopi	Projekti "Shkolla, qender komunitare": Ndërtimi i 4 terreneve sportive në shkolla të qytetit Peshkopi (shkolla "Nazmi Rrushti; shkolla "Demir Gashi"; shkolla "Seit Najdeni"; shkolla "Selim Alliu")	31,261,190	19,319,774	19,319,774	
		QARKU DURRES				
10	Bashkia Krujë	Rikonstruksion dhe shtesë anësore në shkollën 9-vjeçare Nr.4, Kruje, Bashkia Kruje	56,546,095	29,673,048		
11	Komuna Nikel	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Ramazan Karaj", Nikel, Komuna Nikel	27,952,323	14,812,470		
12	Bashkia Fushë-kruje	Ndërtim i shkollës së mesme "Shote Galica" Fushë-Kruje	163,231,283	81,901,868		
13	Bashkia Durrës	Ndërtimi i murit rrethues i shkollës "Beqir Çela", Shkozet		2,195,508	2,195,508	
		QARKU ELBASAN				
14	Bashkia Belsh	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Halit Uruci" Belsh, Bashkia Belsh	59,762,348	28,956,288		6,901,121
15	Komuna Stebleve	Ndërtim shkollë 1 katëshe, Shkolla Fushë-Studenti, Komuna Steblevë, Librazhd	16,595,565	8,450,744		

16	Komuna Rrajce	Ndertim shkolla CU Urake, Komuna Rrajce	5,803,069	4,500,269		1,302,800
17	Komuna Orenje	Ndertim shkolla vartese Fshati Zdrajsh Verri, Komuna Orenje	4,000,000	4,164,354		
18	Komuna Qender Librazhd	Rikonstruksion shkolla 9-vjecare Babje, Komuna Qender Librazhd	6,448,248	5,359,987		1,088,261
19	Komuna Qukes	Rikonstruksion shkolla 9-vjecare "Naim Frasheri"Pishkash, Komuna Qukes	9,591,133	4,851,959		4,739,174
20	Bashkia Elbasan	Perfundim i punimeve ne shkollen "Xhafer Hakani", Elbasan	12,000,000	6,000,000		0
21	Komuna Kukur	Rikonstruksion shkolla e bashkuar "Muharrem Zela" Komuna Kukur	20,934,861	10,602,852		0
22	Bashkia Prenjas	Rikonstruksion dhe rrethim shkolla e mesme "Halit Berzeshta" Prenjas, Bashkia Prenjas	10,682,208	8,131,168		0
		QARKU FIER				
23	Komuna Mbrostar	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Hiqmet Buzi", fshati Kallm, Komuna Mbrostar	25,655,995	12,443,688		13,212,307
24	Komuna Portez	Ndertim kopshti, Komuna Portez	7,970,648	5,550,000		0
25	Komuna Dushk	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Thanasaj, Komuna Dushk	15,658,261	8,083,654		7,574,607
26	Komuna Dushk	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Riza Iberliy" Zhame-Sektor, Komuna Dushk	28,433,206	14,600,000		13,833,206
27	Komuna Fratar	Ndërtim kopshti i ri, Komuna Fratar	8,594,244	4,385,391		4,208,853
28	Komuna Grabian	Ndertim kopshti, Fshati 3 Urat, Komuna Grabian	4,431,432	2,419,209		2,012,223
29	Bashkia Patos	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Zhani Ciko", Patos	42,000,000	20,712,154		0
30	Bashkia Divjakë	Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Miti Zaka", Bashkia Divjakë	17,657,328	9,483,400		8,173,928
31	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Andon Xoxa" Fier	33,315,328	17,317,955		0
32	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Jani Bakalli" Fier	22,107,000	11,053,611		0
		QARKU GJIROKASTER				
33	Bashkia Gjirokastër	Rikonstruksion I shkollës së mesme "Siri Shapllo", Bashkia Gjirokastër	33,045,000	18,163,567		0
34	Komuna Qesarat	Rikonstruksion shkolla CU fshati Ane-Vjose, Komuna Qesarat, Tepelene	5,143,853	5,785,412	641,559	
	Bashkia Gjirokastër	Terrene sportive në 4 shkolla (Shkolla "Pandeli Sotiri"; Shkolla "Thoma Papapano"; Shkolla "Cajupi"; Shkolla "Siri Shapllo", lagje Granicë)	28,050,728	18,232,973	18,232,973	
		QARKU KORCE				
35	Bashkia Korçë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Mësonjtorja e parë"	53,644,475	28,058,008		21,941,992
36	Bashkia Korçë	Projekti "Shkolla, qendër komunitare" : Terrene sportive në 4 shkolla të qytetit Korcë (Shkolla "Demokracia"; Shkolla "Naum Veqilharxhi"; Shkolla "Sotir Gurra"; kompleksi shkollor Rruga "Ajet Xhindoli")		24,115,000		10,885,000

37	Bashkia Maliq	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Kolanec, Bashkia Maliq	2,902,194	2,049,000		853,194
38	Bashkia Maliq	Rikonstruksion nyje sanitare të shkollës së mesme Maliq	1,424,460	1,091,500		332,960
39	Komuna Voskop	Rikonstruksion i shkollës së mesme Voskop sistem ngrohje , Komuna Voskop	35,880,360	17,340,630		14,495,281
40	Komuna Libonik	Ndertim i shkolles cikli i ulet, fshati Poceste, komuna Libonik	14,010,000	7,617,097		0
QARKU KUKES						
41	Komuna Arren	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare, Arren.	22,190,485	12,095,243		0
42	Bashkia Kukës	Ndërtim i shtesës së shkollës 9-vjeçare "Bajram Curri", Kukës	113,007,475	81,210,826		0
43	Bashkia Krume	Rikonsruksion i shkolles 9 vjecare Zahrisht, Faza II, Bashkia Krume	14,270,275	7,162,806		7,107,469
QARKU LEZHE						
44	Bashkia Lezhë	Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës, Bashkia Lezhë		13,679,966	6,839,983	
45	Bashkia Rubik	Sistemi i ngrohjes shkolla 9-vjeçare Rubik, Bashkia Rubik	7,965,031	4,023,422		3,941,609
46	Komuna Kacinar	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Kaçinar, Mirditë	14,533,260	8,000,000		0
47	Komuna Blinisht	Rikonstruksioni i shkolles "Pjeter Zahrishi", Komuna Blinisht, Lezhe	21,300,000	10,736,424	5,368,212	
QARKU SHKODER						
48	Bashkia Vau i Dejës	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Aleksandër Paloci" Shelqet, Bashkia Vau i Dejës (shkollë e djegur)	3,649,518	2,921,198		728,320
49	Komuna Bërdicë	Rikonstruksion i shkollës 9- vjeçare "Berdice e Madhe", Komuna Berdice	19,800,000	9,993,976		
50	Komuna Gruemirë	Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Gruemirë, Komuna Gruemirë	22,195,654	10,601,502		
51	Komuna Shale	Rikonstruksioni i shkolles 9-vjeçare fshati Gimaj, Komuna Shale	25,359,356	15,250,179		
52	Komuna Fierze	Ndertim i shkolles 9-vjecare, fshati Mezi, Puke	28,626,278	14,513,434		
QARKU TIRANE						
53	Bashkia Kavajë	Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr.4 tek rruga "Sufajve" komuniteti i romeve Kavaje	28,359,000	10,396,869		3,782,631
54	Komuna Dajt	Shtesë kati i shkollës 9-vjeçare Qesarakë, Komuna Dajt	46,699,592	22,826,749		523,047
55	Komuna Vaqarr	Rikonstruksion , shtesë anësore 2 kate dhe palestër për shkollën e mesme të pergjithshme, Komuna Vaqarr		15,175,938	7,587,969	
56	Komuna Ndroq	Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Sadi Nuri", Komuna Ndroq	23,643,197	12,249,199		0
57	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion i plotë dhe shtesë ambientesh në shkollën e mesme "Qemal Stafa", Njësia 10		99,594,599	94,594,599	
58	Njesia Bashkiake Nr.2	Rikonstruksion i nyjeve sanitare, Shkolla Ekonomike Tirane	900,000	900,000		0

	Bashkia Tiranë	Projekti "Shkolla, qender komunitare"; Terrene sportive në 4 shkolla 9-vjeçare të qytetit Tiranë (shkolla "7 Marsi" prej 6,800,987L; shkolla "Shkolla e Kuqe" prej 3,515,111L; shkolla "Servete Maci" prej 3,515,111L; shkolla "Skënder Luarasi" prej 3,515,111)	17,346,320	11,275,108	11,275,108	
QARKU VLORE						
59	Komuna Novoselë	Ndërtim shkolla 9-vjeçare "Pilo Prifti", fshati Novoselë, Komuna Novosëlë	47,497,121	23,330,826		5,167,446
60	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion kopshti nr.10, Vlorë, Bashkia Vlorë	12,455,832	10,200,165		0
61	Komuna Brataj	Shkolla e mesme e bashkuar "Hamdi Rrap Lazaj" Gjorm, Komuna Brataj	19,618,223	9,995,023		0
62	Komuna Vranisht	Rikonstruksion shkolla e bashkuar Hore Vranisht, Komuna Vranisht	45,618,775	23,035,616		0
63	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Zigur Lelo" Vlore, Bashkia Vlorë	20,748,570	11,014,800		9,733,770
64	Bashkia Sarandë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare, Gjashtë, Sarandë		15,000,000	15,000,000	0
65	Bashkia Sarandë	Ndërtimi i kopshtit në zonën e sipërme urbane		16,845,200	16,845,200	
		TOTALI	**1,592,291,845**	**1,073,266,814**	**207,120,142**	**180,234,278**

Shënim

1. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim.
2. "Vlera e financimit" për vitin 2014 tregon vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas vendimeve respektive të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
3. "Fonde që reduktohen" për vitin 2014, tregon vlerën e financimit që i zbritet vlerës së financimit, të parashikuar për vitin 2014, për projektet me performancë të ulët, në zbatimin e punimeve.
4. "Fonde që shtohen" për vitin 2014, tregon vlerën e financimit, që i shtohen vlerës së financimit të parashikuar për vitin 2014, për projektet me ecuri punimesh përtej parashikimeve financiare, në 2014.